



UNIVERSITETI I TETOVËS

UNIVERSITY OF TETOVA - УНИВЕРЗИТЕТ ВО ТЕТОВО

UT Rectorate - Ilinden nn. 1200 Tetovë, Macedonia
Tel: +389 44 356 500, Fax: +389 44 334 222, email: international@unite.edu.mk

Fakulteti Ekonomik - Тетовë | Македониë | сà Vertut
Т-Економски факултет | Шутица | Селвина Македониë

Nr.-Бр. 14-385/11

16-06-2020 viti/год.
Tetovë ТЕТОВО

FAKULTETI EKONOMIK

Studimet e Doktoraturës

Drejtimi: Ekonomi e Aplikuar

RAPORTI I MENTORIT

PËR VLERËSIMIN E DISERTACIONIT TË DOKTORATURËS TË KANDIDATIT- HAQIF ARIFI

Kandidati-Doktorant **Haqif Arifi** që nga momenti i fillimit të studimeve të doktoraturës në Fakultetin Ekonomik, UT, viti akademik-2015/2016 me sukses i ka përbushur të gjitha obligimet e definuara në këtë program studimor të ciklit të tretë- Ekonomi e Aplikuar, e që kanë të bëjnë me dhënien e provimeve përkatëse, realizimin e aktiviteteve nëpër konferencat e ndryshme doktorale në kuadër të Fakultetit Ekonomik, përmes publikimeve përkatëse nëpër Revistat e ndryshme ndërkombëtare që përbushin kriteret obligative në nivel të studimeve të doktoraturës si dhe aktivitete tjera dhe të ndryshme profesionale dhe shkencore etj.

Gjitha këto momente si dhe puna e tij shumëvjeçare në Klinikat Universitare në Prishtinë në sektorin e “Shërbimeve të përgjithshme”, e sidomos puna e tij në sferën e shëndetësisë, si njëra nga sferat shumë të rëndësishme të Sektorit Publik, prej nga dhe është motivuar për realizimin e këtij punimi të doktoraturës që tangon çështjen e financimit të këtij sektori të shërbimit publik.

Kandidati-Doktorant Haqif Arifi, në bazë të njohurive profesionale shumëvjeçare që ka përfutuar nga sfera e financimit të shërbimeve publike në pjesën e shëndetësisë si dhe në bazë të interesimeve si dhe njohurive të fituara nga pjesa e studimeve permanente, ka përcaktuar, ka koncipuar dhe definuar temën e punimit me titull **“Menaxhimi i shërbimeve shëndetësore në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës dhe faktorët që ndikojnë në cilësinë e shërbimeve”**

Duke u nisur nga ambiciet hulumtuese-shkencore të kandidatit-doktorant Haqif Arifi, me qëllim që të bëjë një trajtim sa më kompleks dhe gjithpërfshirës për çështjet me interes të veçant për zhvillimin ekonomik dhe integrimin sa më të shpejtë euroatlantik të Kosovës ka fokusuar interesimin në analizën e korelacionit në mes financimit të sistemit publik shëndetësor në Kosovë dhe ndërtimit të sistemit efikas dhe funksional të sigurimeve shëndetësore që do të kishin ndikim të drejtëpërdrejtë në zhvillimin e sektorit të përgjithshëm shëndetësor të Kosovës.

Kuptohet se ky studim ka rëndësi të veçant hulumtuese-shkencore dhe praktike. Në këtë kontekst, analizat permanente të procesit të ndërtimit të sigurimeve shëndetësore në këtë fazë të tranzicionit ekonomik si dhe, në veçanti, mënyrat e financimit të këtij sigurimi dhe ndikimet përkatëse që do të ketë në buxhetin e Republikës së Kosovës duke i krahasuar edhe modelet nga vendet e rajonit do të ofrojnë bazë solide të evidencës për politikëbërje në fushën e shëndetësisë në Kosovë.

Poashtu, në bazë të punës efikase dhe produktive që ka realizuar kandidati në teren, janë siguruar opinione përkatëse lidhur me prononcimet e qytetarëve të Kosovës (pacienëve), me shërbimet që ata i marrin nëpër këto institucione publike, trajtimin e tyre nga profesionistët shëndetësor dhe pritjet e tyre që të marrin shërbime përkatëse cilësore .

Përndryshe, në punim është theksuar fakti që Sektori i Shëndetësisë në Kosovë përbën një nga sektorët më të rëndësishëm dhe vazhdimisht, nga ana e institucioneve përkatëse, i deklaruar si prioritar për zhvillimet e vendit. Bazuar në këtë rëndësi specifike edhe reformat bashkëkohore që duhen ndërmarrë në këtë sektor marrin një rëndësi të veçantë. Kjo është arsyeja që shumë studiues janë duke vlerësuar dhe studiuar mënyrat që do të ndikonin në një menaxhim më të mirë të këtij sektori. Studimi është fokusuar pikërisht në sektorin e shëndetësisë publike dhe ka për objektive të trajtoj rëndësinë e rritjes së financimit nga buxheti i Kosovës në funksion të rritjes së produktivitetit dhe të efikasësisë në sistemin shëndetësor në Kosovë dhe veçanërisht të fillimit të zbatimit të sistemit të sigurimeve shëndetësore si një domosdoshmëri për të ndihmuar në zgjidhjen e problemeve lidhur me kufizimet e buxhetit në dispozicion për Sektorin, në funksion për ofrimin e shërbimeve më të mira dhe pagesën e pagave të arsyeshme për stafin mjekësor.

Në bazë të elaborimit më lartë të prezantuar, nga ana e kandidatit janë definuar dhe koncipuar këto dilema të sublimuara në formë të Hipotezave përkatëse:

H₁ “Niveli i financimit të sistemit shëndetësor në Kosovë nuk është në përputhje me nevojat e popullatës”

H₂ “Zbatimi i sistemit të sigurimeve shëndetësore, ndikon pozitivisht në rritjen e financimit dhe të cilësisë së shërbimeve shëndetësore në Kosovë”

H₃ “Menaxhimi joprofesional dhe ndikimet politike kanë ndikim drejtpërdrejtë në funksionimin e QKUK-së”

H₄ “Niveli i shërbimeve shëndetësore në QKUK është ende larg përmbushjes të ofrimit të shërbimeve cilësore”

Në këtë kontekst të formulimit të pyetjeve kërkimore dhe aspekti i testimit të të njëjtave, kandidati ka përcaktuar si variabla të pavarura- llojin e ndryshimeve në këtë sferë, faktorët e proceseve dhe historinë e ndryshimeve si variabla të pavarura të ambientit. Ndërsa- suksesin e ndryshimeve kualitative ka përcaktuar si variabël i varur të modelit, në kuadër të të cilit model janë përfshirë edhe dy variabla kontrolli: madhësia dhe mosha e ndërmarrjes.

Realishtë, çështja e fondeve ekzistuese në R e Kosovës dhe metodat e financimit të shëndetësisë publike aktualisht nuk mund t,i plotësojnë dhe t’iu përgjigjen nevojave gjithnkë në rritje dhe në këtë punim janë ofruar modele përkatëse efikase të implementimit të sistemit të sigurimeve shëndetësore, duke reflektuar nevojën e rritjes permanente të nivelit të shpenzimeve në sektorin publik shëndetësor për t,i evituar shpenzimet financiare për familjet dhe individët dhe, kuptohet, duke i reduktuar pagesat (shpenzimet) që financohen nga buxheti personal i pacientëve, drejtpërdrejtë për këto shërbime.

Në këtë hulumtim pra është trajtuar financimi i sektorit të shëndetësisë në Kosovë dhe nevoja për fillimin e zbatimit të sistemit të sigurimeve shëndetësore. Rëndësia e rritjes së financimit të sistemit shëndetësor në Kosovë dhe analiza e mundësive të koncipimit të një sistemi funksional dhe efikas të sigurimeve shëndetësore që do të mund të aplikohen në Kosovë, janë paraqitur si detyra kryesore mbi të cilat është fokusuar autori i këtij hulumtimi, duke u bazuar në të dhënat relevante të cilat dëshmojnë për nevojat dhe vështirësitë me të cilat ballafaqohen qytetarët e Kosovës për të siguruar shërbime shëndetësore efikase dhe profesionale.

Poashtu, në këtë punim nga ana e kandidatit është synuar që përmes punës në teren të sigurohen rezultate përmes intervistave të ndryshme dhe anketimet e realizuarë- si me pacientë poashtu edhe me të gjithë të interesuarit tjerë për çështjen e “Performancave të nevojshme në shërbimet shëndetësore dhe në cilësinë e shërbimeve kualitative në sferën e shëndetësisë publike”, në përgjithësi, në Qendren Klinike Universitare të Kosovës dhe në të gjitha spitalet regjionale në Kosovë.

Që prej momentit të regjistrimit të studimeve të Doktoraturës – Viti Akademik 2015/2016, kandidati-Doktorant Haqif Arifi në periudhën e kaluar, në mënyrë aktive, është përfshirë në definimin, koncipimin si dhe në realizimin e aktiviteteve të hulumtimit dhe të analizës së problemeve që janë të lidhura në mënyrë direkte ose indirekte me temën e sipërmendur.

Në këtë kontekst, unë si mentor i kandidatit në fjalë, kam qenë në kontakt të vazhdueshëm me të duke e përkrahur dhe duke i dhënë sugjerime gjatë gjithë kohës deri sa e ka përfunduar temën e doktoraturës.

Në vazhdim të Raportit, kandidati-doktorant ka marrë pjesë në disa konferenca tematike për problematikën në fjalë e sidomos në realizimin e disa punimeve me karakter ndërkombëtar dhe kriteret e definuara për publikimin e këtyre punimeve (në përputhje me rregullativat ligjore në këtë sferë të arsimit të lartë), të cilët punime kanë orientimet hulumtuese-shkencore me temën e definuar të doktoraturës.

Përndryshe, kandidati doktorant-Haqif Arifi në opusin e tij të pasur profesional ka shënuar momente të ndryshme lidhur me angazhimet e tij profesionale në Qendrën Klinike të Prishtinës duke i theksuar pozicionet e tij të ndryshme në udhëheqjen e këtij institucioni të rëndësishëm shëndetësor me karakter publik (Menaxher i grupit klinik, shef i sektorit të administratës dhe shumë angazhime tjera .).

Në këtë kontekst duhet theksuar edhe angazhimet e tij dhe përvojën e fituar në sferën e arsimit të lartë, gjegjësisht, angazhimet e tij si asistent, në vitin akademik 2014/2015 në Kolegjin “Pjetër Budi” në Prishtinë dhe pastaj edhe si ligjërues në të njëjtin institucion të arsimit të lartë prej vitit 2015.

Aktivitetet e pandërprera në sferat profesionale dhe shkencore vazhdojnë të jenë motivacionet kryesore të kandidatit, angazhimet permanente të cilat i ka realizuar përmes pjesëmarrjes nëpër konferenca të ndryshme ndërkombëtare siqë janë:

- Me 01 Dhjetor 2017, Tetovë, në **Konferencën e Pestë Shkencore Ndërkombëtare** me temë “Efektet Ekonomike të Procesit të Migracionit në Ballkanin Perëndimor” organizuar nga Fakulteti Ekonomik me Fakultetin e Administrim Biznesi-**Universiteti**

Shtetëror i Tetovës me temë "Rëndësia e Financimit dhe Sigurimeve Shëndetësore në Sektorin e Shëndetësisë";

- Me 01 Dhjetor 2017, Tetovë, në të njëjtën Konferencë e Pestë Shkencore Ndërkombëtare me temë "Efektet Ekonomike të Procesit të Migracionit në Ballkanin Perëndimor", organizuar nga Universiteti Shtetëror i Tetovës, me temë: **"Globalizimi dhe Politikat Rekrutuese të Menaxherëve"** si autor i dyte. Qershor 2017;

-**Gazeta e Hulumtimeve dhe Inovacionit Shkencor të Avancuar, Gjermani, Vëllimi 11, nr 31, me temë "Information and Technology Menagment Systems in Public Hospitals"** (Sistemet e Menaxhimit të Informacionit dhe Teknologjisë në Spitalet Publike), ISSN: 21931811;

- Pjesëmarrja me 31 Mars 2017, Ulqin - Mali i Zi, në Konferencën e Nëntë: Roli dhe efektiviteti i investimeve në procesin e integritit të shoqërive ballkanike pas Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit E-ISSN 2337- 0521 ISSN 1800-9794 me temë **"Format kryesore të organizimit të bizneseve"**;

-Pjesëmarrje në Konferencën e Katërt Shkencore Ndërkombëtare me temë "Efektet Ekonomike të Procesit të Migracionit në Ballkanin Perëndimor", 02 Dhjetor 2016, organizuar nga Universiteti Shtetëror i Tetovës, me temën e punimit **"Stresi në vendin e punës"**- Revista Nderkombetare e Publikimeve Shkencore dhe Kerkimore Vellimi 8 ,Issue 8,Gusht 2018;

-Pjesëmarrja në Konferencën e Shtatë Ndërkombëtare me temë: Tendencat bashkekohore ekonomike, me titullin e punimit **"Ndikimi i Financimit në shëndetësi dhe impakti në cilësinë e shërbimeve spitalore - Rasti Kosova, 01 Dhjetor 2017, Tetovë - Maqedoni,**

-Pjesëmarrja në Konferencën e Tetë ndërkombëtare e mbajtur më- 01 Prill 2016, në Ulqin - Mali i Zi, me temën-"Roli dhe efektiviteti i investimeve në procesin e integritit te shoqërive ballkanike pas Marrëveshjes së Stabilizim Asocimit, me temë "Turizmi dhe hoteleria si faktor në zhvillimin ekonomik";

- Pjesëmarrja në Konferencën e Shtatë ndërkombëtare shkencore me temën "Contemporary Economic Trends"-CET,2019, me punim me titull-"**Ekzistimi i formave të ndryshme organizative e NVM -ve në Kosovë**", që është realizuar nga Fakulteti Ekonomik, Fakulteti i Administrim Biznesi-USHT, dhe Fakulteti Ekonomik-Universiteti i Maltës, mbajtur më 13.11.2019, në Tetovë;

Kandidati për Doktoraturë në vazhdimësinë e aktiviteteve të tij në sferën profesionale, në opusin e tij të begatshëm, ka realizuar edhe shumë aktivitete në formë të trajnimeve të ndryshme siqë janë:

- Trajnim profesional "Menaxhimi strategjik - administrimi i komunikimit te brendshem, projekteve, zyres, dosjeve si dhe planifikimi i burimeve njerezore", Dubrovnik - Kroaci 22 - 25 Maj 2014;
- Trajnim lidhur me Menaxhimin e Resurseve Njerezore ne Kosove, Stamboll - Turqi 20 - 23 Mars 2013;
- Trajnim që korespondonte me Detyrat dhe Obligimet e Institucioneve Shendetesore Publike dhe Private Ndaj Ligjit per mbrojtjen e te Dhenave Personale, Durres - Shqiperi 10 - 13 Gusht 2012;
- Trajnim lidhur me Hartimin dhe komunikimin e shkresave në Administratë publike, 12 - 13 Qershor 2007 ;
- Trajnim lidhur me "Të drejtat e njeriut me theks të veçante ne Kosovë", 8 - 9 Qershor 2005;
- Trajnim në temën e Procedurave të personelit, 14.01.2004-20.04.2005;
- Trajnim në sferën e "Sistemit të ri të gradimit, paga dhe shtesa", 5 - 8 Qershor 2004;
- Kurs për kompjuter (Word, Excel, Power Point), Mars/2002 - Qershor/2002;
- Trajnim në menaxhim: Menaxhim për herë të parë, Shkathtësi të komunikimit, Zgjidhje e problemit dhe Mësimi dhe motivimi, Janar - Shkurt 2020;

Tani, sa i përket pjesës së punimit të doktoraturës, kandidati-doktorant në mënyrë aktive, duke bashkëpunuar dhe konsultuar si me mentorin, poashtu, edhe me të gjithë ata që kanë patur njohuri nga kjo sferë të punimit, me qëllim që të sigurojë të dhëna të ndryshme kualitative të karakterit primar dhe sekondar, në funksion të koncipimit, përgatitjes dhe të përfundimit të temës së disertacionit të doktoraturës, ka përcjellë dhe zbatuar parakushtet e nevojshme në punim në mënyrë që t,i plotësojë standardet e nevojshme për një punim kualitativ në nivel të doktoraturës.

Si në çdo punim i këtij karakteri, edhe në kuadër të këtij punim të doktoraturës është bërë një qasje adekuate metodologjike, e cila është fokusuar në aplikimin e metodave bashkëkohore që zbatohen në shkencat organizativo-ekonomike siq janë: metoda komparative (krahasuese),

metoda historike, metoda e analizës, metoda e modeleve përmes së cilave do të trajtojmë modelet e ndryshme mbi formën e financimit të sistemit shëndetësor dhe ndërtimit të sistemeve të sigurimeve shëndetësore, metoda induktive, metoda deduktive, metoda deskriptive etj.

Aspekti krahasimor apo komparativ ka zënë një vend të posaçëm në këtë punim, e cila metodë ka përfshirë aspektin krahasimor me vendet e rajonit që e kanë ndërtuar sistemin shëndetësor dhe kanë përmirësuar sistemin e mbledhjes së të hyrave publike dhe menaxhimin e tyre në funksion të përmirësimit të gjendjes në sektorin e shëndetësisë publike. Nga ana e kandidatit, në mënyrë suksese është kushtuar rëndësi të posaçme sistemit të sigurimeve shëndetësore para luftës, pas luftës dhe pas pavarësimit të vendit tonë, për të dhënë një pasqyrë për të ardhmen.

Elaborimi i mëtutjeshëm është përqendruar në analizën e shpenzimeve buxhetore për sektorin e shëndetësisë publike si dhe gjetjen e mundësive të ndryshme për format e financimit dhe përmirësimit të të hyrave publike në mënyrë që ndërtimi i sistemit të sigurimeve shëndetësore të jetë i plotë, pa ngarkesë të theksuar buxhetore dhe të ndikoj në përmirësimin e gjendjes në këtë sektor.

Duke pasur parasysh objektin dhe metodën e trajtimit, struktura e punimit të doktoratures në fjalë është radhitur në pesë pjesë kryesore (Kaptina) duke mos përfshirë pjesën hyrëse dhe pjesën përfundimtare me sugjerimet si dhe pjesën e Literaturës së konsultuar.

Duhet theksuar momentin se është shumë e rëndësishme që në kuadër të trajtimit të çështjes së financimit të sektorit të shëndetësisë publike në Kosovë, është marrë parasysh edhe çështja e domosdoshmërisë nga ekzistimi dhe funksionimi efikas i një sistemi të sigurimeve shëndetësore, për arsye se rëndësia nga ekzistimi i një sistemi funksional shëndetësor në relacion me sistemin e përgjithshëm të sigurimeve shëndetësore pozicionon këtë institucion në përqëndrimin e tij në drejtim të ofertës së shërbimeve kualitative të cilat kryhen nga institucionet shëndetësore publike. Në këtë drejtim, në mënyrë shumë elaborative janë paraqitur momentet e ndryshme lidhur me gjendjen aktuale e sistemit shëndetësor duke bërë një analizë retrospektive nëpër etapa të ndryshme.

Në kuadër të objektivave tjera të punimit është edhe ajo që analizon problematikat që shkaktojnë mungesa të karakterit objektiv dhe subjektiv nga ekzistimi i një sistemi efikas të sigurimeve

shëndetësore dhe vështirësitë për qasje të barabartë të të gjithëve në shërbimet shëndetësore të karakterit publik.

Në këtë kontekst, kandidati ka trajtuar edhe efektet e ndryshme të mungesës së sigurimeve shëndetësore në raport me të drejtat e njeriut në përgjithësi, e veçanërisht efektet ndaj shtresave të caktuara sociale, si familjet/personat që jetojnë nën asistencë sociale, kategoria e pensionistëve, familjet e dëshmorëve dhe invalidët e luftës etj.

Në kuadër të tekstit janë prezantuar edhe raporte të ndryshme vendore dhe ndërkombëtare që kanë treguar se Kosovarët janë shumë pak të kënaqur me shërbimet shëndetësore të sferës publike, sidomos të dhënat e siguruar nga institucionet përkatëse dhe nga qytetarët që kanë treguar edhe momentin e dukurive të ndryshme shoqërore sikur që është dimensionin socio-ekonomik i korrupsionit, i cili fenomen është shumë i pranishëm në këtë sferë dhe paraqet sfida serioze për shërbimet e kujdesit shëndetësor.

Prandaj, në bazë të këtyre dukurive, aftësia për të ndërtuar, zhvilluar dhe mirëmbajtur një sistem funksional dhe efikas shëndetësor është thelbësore për përparimin e përgjithshëm të mirëqenies së popullit. Në këtë aspekt, është theksuar se reformat e vazhdueshme të infrastrukturës së sistemit shëndetësor, posaçërisht ato të financimit, komisionimit dhe ofrimit të shërbimeve shëndetësore janë në ballë të agjendës së reformave globale.

Përndryshe, sikur që është theksuar edhe më lartë, në kuadër të obligimeve hulumtuese-shkencore që kanë të bëjnë me aspektin e realizimit të aktiviteteve permanente në sferën e zgjedhur, kandidati doktorant ka realizuar dhe ka publikuar edhe 2-punime relevante për temën e definuar që kanë këto përkufizime:

1. Punimi i Parë- "Information and Technology Management Systems in Public Hospitals" (Sistemet e Menaxhimit të Informacionit dhe Teknologjisë në Spitalet Publike), *Journals JASRI*, 2017, Volume 11, No.31, ISSN: 21931811, Germany;

2. Punimi i Dytë "Ndikimi i Financimit në shëndetësi dhe impakti në cilësinë e shërbimeve spitalore - Rasti Kosova, *Revista Nderkombetare e Publikimeve Shkencore dhe Kerkimore Vellimi 8*, Issue 8, Gusht 2018, ISSN 2250-3153;

Përmbajtja e përfshirë në punimin e doktoraturës ka këtë strukturim:

Hyrje: kjo pjesë e punimit përmban sqarimin e përgjithshëm të temës së përfshirë e cila është trajtuar gjërësisht kurse në pika të shkurta janë trajtuar qëllimi i temës, pastaj mënyra se si është

realizuar punimi i doktoraturës duke i paraqitur edhe arsyet pse është objekt studimi, pikërisht, tema mbi financimin e sistemit shëndetësor dhe ndërtimi i sistemit të sigurimeve shëndetësore si dhe pritshmëria në cilësinë e shërbimeve që u ofrohen qytetarëve të Kosovës, pastaj, prezantimi i metodologjisë së punës që është përdorur në këtë punim si dhe kontributi shkencor dhe praktik i këtij punimi.

Kapitulli i parë – në këtë pjesë të punimit janë ofruar aspektet e përgjithshme teorike mbi historikun e ndërtimit të sistemit shëndetësor në Kosovë, ndërtimin e buxhetit të Kosovës dhe ndarjen e këtij buxheti për shëndetësi për periudhën 2008-2015. Gjithashtu në këtë pjesë është trajtuar edhe sistemi i sigurimeve shëndetësore në Kosovë që prej fillimit e deri me sot.

Kapitulli i dytë – në kuadër të kësaj pjese është bërë një analizë mbi financimin e sistemit shëndetësor në Kosovë duke i krahasuar edhe sistemet ekzistuese në financimin e sistemit shëndetësor në vendet e rajonit si Shqipëria dhe Maqedonia.

Kapitulli i tretë – në këtë pjesë është analizuar infrastruktura ekzistuese ligjore në sektorin e shëndetësisë publike në Kosovë, e drejta për sigurime shëndetësore dhe normat ligjore vendore dhe ndërkombëtare që e rregullojnë këtë të drejtë. Pastaj është trajtuar aspekti i infrastrukturës ekzistuese ligjore mbi sigurimet shëndetësore në Kosovë dhe analiza e çështjeve të cilat janë të rëndësishme për financimin e shëndetësisë dhe sigurimit shëndetësor. Në kuadër të kësaj pjese është bërë edhe analiza e mundësive të krijimit të fondit të sigurimeve shëndetësore në Kosovë.

Kapitulli i katërt - temat që janë përfshirë në këtë kapitull së bashku me temat nga kapitulli i tretë paraqesin thelbin e studimit, pasi që në këtë janë trajtuar çështje të ndryshme me rëndësi të financimit të shëndetësisë dhe të sigurimit shëndetësor në Kosovë si dhe modele të ndryshme për sigurime shëndetësore që i aplikojnë vendet e rajonit. Në vazhdim të kësaj pjese janë paraqitur disa parashikime se sa do të jetë ndikimi i sigurimeve shëndetësore në buxhet dhe në ekonominë e përgjithshme të vendit dhe se çfarë efekte do të sillte fillimi i zbatimit të ligjit për sigurime shëndetësore.

Kapitulli i pestë- në këtë kapitull, në mënyrë përmbledhëse, janë prezentuar të gjeturat të cilat janë evidentuar gjatë hulumtimit në sistemin shëndetësor të Kosovës në funksionimin e institucioneve shëndetësore regjionale si që janë- spitalet e ndryshme regjionale në Ferizaj, Gjilan, Prizren, Gjakovë, Pejë, Mitrovicë, Vushtri dhe në, veçanti, QKUK-Prishtinë, të cilat të

dhëna janë analizuar nga ana e kandidatit-doktorant, si dhe rezultatet e fituara gjate anketimit me pacientë, krahasimin e tyre për nivelin e shërbimeve të ofruara pacienteve, kushtet, dhe praninë e dukurisë së ryshfetit nëpër këto institucione shëndetësore etj.

Përfundimi –Në pjesën e përfundimit të punimit, në bazë të analizave krahasuese dhe në bazë të përfundimeve logjike janë nxjerrë konkluzionet përkatëse të punimit që korespondojnë me problematikën e hulumtuar. Kuptohet, në mënyrë suksesive dhe kausale dhe, pastaj, në formë sublimative janë evidentuar rezultatet e hulumtimit nga kjo sferë shumë të rëndësishëm të sistemit publik shëndetësor të Kosovës.

Rekomandimet – Kuptohet, si çdo një punim të karakterit hulumtues-shkencor, edhe në këtë punim kandidati-doktorant Haqif Arifi, në mënyrë profesionale formulon dhe definojnë disa sugjerime në formë të rekomandimeve përkatëse që kanë të bëjnë me modelin më efikas për financimin e sektorit të shëndetësisë publike si dhe ndërtimin e një sistemit funksional dhe i pranueshëm të sigurimeve shëndetësore, me qëllim që të rritet cilësia e shërbimeve të ofruara shëndetësore në sektorin publik në mënyrë që pacientët të jenë të kënaqur me kualitetin e këtyre shërbimeve.

Dhe në fund, në funksion të prezantimit të burimeve plotësuese të sigurimit të të dhënave për realizimin më kualitativ të punimit, nga ana e kandidatit-doktorant është prezantuar pjesa e **Literaturës së shfrytëzuar** dhe të konsultuar.

Përndryshe, punimi i doktoraturës së kandidatit-doktorant Haqif Arifi, është hartuar në gjithsejt 202- faqe standarde të përfshira në 5-kaptina përkatëse, të definuara dhe të parashtruara sipas një korelacioni në mes tyre, duke përfshirë 27-tabela përkatëse, 16-figura, 3-grafikona si dhe një listë të shkurtesave, gjitha këto forma aplikative në funksion të prezantimit sa më të kuptueshëm dhe më të qartë të materialit të përfshirë në punim.

PËRFUNDIM me PROPOZIM

Në bazë të asaj që është prezantuar më lartë, komisioni konstaton se punimi me titull **“Menaxhimi i shërbimeve shëndetësore në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës dhe faktorët që ndikojnë në cilësinë e shërbimeve”** i punuar nga kandidati M-r. Sc. Haqif Arifi, sipas esencës së saj, vëllimit, mënyrës së përpunimit, interpretimit të rezultateve dhe përfundimit, paraqet një punim i mëvetësuar hulumtues-shkencor i cili plotëson kushtet, standardet dhe

kriteret e nevojshme në përputhje me rreguloren për studimet e doktoraturës në Universitetin e Tetovës.

Komisioni, në mënyrë pozitive, vlerëson punimin e doktoraturës dhe i propozon Këshillit Mësimor-Shkencor të Fakultetit Ekonomik që të aprovoj këtë raport si dhe t,i mundësoj kandidatit për doktoraturë- **Mr. Haqif Arifi** në mënyrë publike, para Komisionit 5-anëtarësh ta prezantoj dhe ta mbrojë punimin e tij të doktoraturës me titull **“MENAXHIMI I SHËRBIMEVE SHËNDETËSORE NË QENDRËN KLINIKE UNIVERSITARE TË KOSOVËS DHE FAKTORËT QË NDIKOJNË NË CILËSINË E SHËRBIMEVE”**

ANËTARËT E KOMISIONIT:

1. Prof. Dr. Raman Ismaili-kryetar,

2. Prof Dr. Mislim Zendeli-anëtar.

3. Prof.Dr. Arun Tairi-anëtar,

4. Prof.Dr. Nail Reshiti-anëtar,

5. Prof.Dr.Naser Raimi-mentor,

kriteret e nevojshme në përputhje me rreguloren për studimet e doktoraturës në Universitetin e Tetovës.

Komisioni, në mënyrë pozitive, vlerëson punimin e doktoraturës dhe i propozon Këshillit Mësimor-Shkencor të Fakultetit Ekonomik që të aprovoj këtë raport si dhe t.i mundësoj kandidatit për doktoraturë- **Mr. Haqif Arifi** në mënyrë publike, para Komisionit 5-anëtarësh ta prezantoj dhe ta mbrojë punimin e tij të doktoraturës me titull **“MENAXHIMI I SHËRBIMEVE SHËNDETËSORE NË QENDRËN KLINIKE UNIVERSITARE TË KOSOVËS DHE FAKTORËT QË NDIKOJNË NË CILËSINË E SHËRBIMEVE”**

ANËTARËT E KOMISIONIT:

1. Prof. Dr. Raman Ismaili-kryetar,

2. Prof Dr. Mislum Zendeli-anëtar.

3. Prof.Dr. Arun Tairi-anëtar,

4. Prof.Dr. Nail Reshiti-anëtar,

5. Prof.Dr.Naser Raimi-mentor.